

TUNGJATJETA PRIND I FËMIJËS QË DO TË FILLOJË SHKOLLËN!

Në të gjitha shkollat fillore mësimi i gjuhës së huaj fillon nga klasa e parë.

Gjuha quhet gjuhë A1. Njoftohuni bashkë me fëmijën paraprakisht me alternativat gjuhësore.

Në të gjitha shkollat në Turku si gjuhë A1 mund të mësohet anglishtja.

Nëse nxënësi ndjek mësimet e anglishtes si gjuhë A1, në klasë të katërt ai/ajo mund të zgjedhë edhe gjuhën A2. Nëpër shkolla ka gjuhë të ndryshme A2. Mësimi i suedishtes fillon gjithsesi më së voni në klasën e gjashtë.

Në shkollën Hannunniittu si gjuhë A1 mund të mësohet anglishtja ose spanjishtja.

Grupi i spanjishtes fillon nëse nxënës ka mjaftueshëm. Nëse nxënësi/ja mëson spanjisht si gjuhë A1, ai/ajo do të fillojë anglishten në klasë të katërt. Pos kësaj, suedishtja fillon në klasë të gjashtë.

Nëse fëmija juaj dëshiron të mësojë spanjishten si gjuhë A1, kontaktoni drejtorin e shkollë në Hannunniittu, Timo Lehtinen.

Në shkollën në Luostarinvuori si gjuhë A1 mund të mësohet anglishtja ose suedishtja.

Grupi i suedishtes fillon nëse nxënës ka mjaftueshëm. Nëse nxënësi/ja mëson suedisht si gjuhë A1, ai/ajo do të fillojë anglishten në klasë të katërt.

Nëse fëmija juaj dëshiron të mësojë suedishten si gjuhë A1, kontaktoni drejtorin e shkollës në Luostarinvuori, Juha Mäenpää.

Gjuhën duhet zgjedhur kur të paraqisni fëmijën për shkollë.

Të dhëna shtesë japin:

Marja Haastola, mësuese zhvilluese e mësimit gjuhësor në arsimin fillor në Turku (shkollat e ulëta), tel. 040 482 7927 marja.haastola@edu.turku.fi (gjërat lidhur me mësimin e gjuhëve ose me shtegun gjuhësor)

Drejtori Timo Lehtinen, shkolla në Hannunniittu, tel. 0400 944 245 timo.lehtinen@edu.turku.fi (Gjërat që lidhen me mësimin e spanjishtes A1 në Hannunniittu)

Ndihmësdrejtori Juha Mäenpää, shkolla në Luostarinvuori, njësitë Martti dhe Kerttuli tel. 044 907 4631 juha.maenpaa@edu.turku.fi (gjërat lidhur me suedishten A1 në Luostarinvuori)

Në Turku ka mundësi për të nxënë gjuhë të ndryshme edhe në klasat gjuhësore

Mësimi dygjuhësor në klasat gjuhësore

Për klasat gjuhësore të anglishtes, frëngjishtes dhe gjermanishtes si dhe për klasën finlandisht-rusisht mund të bëhet aplikimi, me rastin e paraqitjes për klasë të parë. Aplikantët ftohen në test për klasat gjuhësore.

Në mësimin dygjuhësor nuk është e nevojshme që fëmija të njehë gjuhën e huaj paraprakisht. Gjatë shkollës fillore, rreth 25 % e mësimin të përmbajtjes së lëndëve mësimore është në gjuhën e synuar. Gjithashtu gjuha A1 e nxënësit është e njëjta gjuhë e synuar. Nxënësit megjithatë mësojnë leximin dhe shkrimin në klasat 1.-2. në gjuhën finlandeze. Lidhur me punën në klasat gjuhësore mund të lexoni më shumë në adresat www.kieliluokat.fi ja www.turku.fi/kieliluokat.

Dushi gjuhësor i suedishtes

Për në klasën e dushit gjuhësor të suedishtes nxënësit zakonisht aplikojnë pas parashkollorit të dushit gjuhësor të suedishtes, mirëpo për atë klasë mund të bëhet aplikimi edhe kur të fillojë shkolla. Për në atë klasë mund të bëhet aplikimi me rastin e paraqitjes për klasë të parë. Të gjithë aplikantët ftohen në test për klasën gjuhësore.

Gjatë programit, nxënësi/ja së paku 50 % të mësimin e merrë në suedisht. Gjatë edukimit të hershëm dhe gjatë parashkollorit pjesa e gjuhës së dushit gjuhësor është pothuajse 100 %, në klasat vjetore 1-2 rreth 90 %, në klasat vjetore 3-4 rreth 70 % dhe në klasat vjetore 5-9 mesatarisht 50 %. Gjuha A1 e nxënësit/es është suedishtja. Nxënësit mësojnë leximin dhe shkrimin në klasat 1.-2. vetëm në gjuhën e dushit gjuhësor. Mund të lexoni më shumë në adresën www.turku.fi/ruotsinkielikylpyluokat.

Të dhëna shtesë jep

Sirkku Alin, mësuese zhvilluese e mësimin dygjuhësor në arsimin fillor në Turku, tel. 040 358 0328, sirkku.alin@edu.turku.fi

Mbrëmjet informative të klasave gjuhësore (shih edhe faqet e internetit të shkollave)

e martë 9.1.2024 ora 18.30 Turku International School <https://sites.utu.fi/tis/>

e martë 9.1.2024 ora 18.00 Puolalan koulu, Kauppiaskatu 14 (anglisht, gjermanisht dhe finlandisht-

rusisht) <https://blog.edu.turku.fi/puolala/>

e mërkurë 10.1.2024 ora 18.00 Vähä-Heikkilän koulu (frëngjisht)

<https://blog.edu.turku.fi/vahaheikkila/>

e enjte 11.1.2024 ora 18.30 Njësia Martti në shkollën Luostarinvuori (dushi gjuhësor i suedishtes) <https://blog.edu.turku.fi/martti/>

e enjte 11.1.2024 ora 18.30 Turun Normaalikoulu (anglisht) <https://sites.utu.fi/tnk/>

Nxënësi/ja fillon anglishten si gjuhë A2 në klasën e katërt (4.), nëse nxënësi/ja në klasën e parë zgjedhë si gjuhë A1 ndonjë gjuhë tjetër pos anglishtes.

Prindi aranzhon transportin për në shkollë, nëse nxënësi në bazë të gjuhës aplikon për një shkollë tjetër pos shkollës së afërme.

Mësimi i gjuhës amtare të nxënësit/es (MAI)

Nxënësi mund të aplikojë për mësim të gjuhës amtare, pra mësimi MAI, nëse gjuha amtare e nxënësit/es nuk është finlandishtja ose suedishtja. Për mësimin MAI mund të aplikojë e dhe nxënësi/ja, që ka mësuar atë gjuhë për shembull në botën e jashtme. Në Turku në këtë moment gjuhë amtare mund të mësohet në 28 gjuhë të ndryshme. Ky mësim plotëson mësimin fillor dhe ai ofrohet dy orë në javë. Për mësimin MAI paraqitjen duhet bërë nëpërmjet programit Wilma, në rubrikën „Hakemukset ja päätökset“ (MAI-hakemus).

Mund të lexoni më shumë në adresën: www.turku.fi/monikulttuurinenopetus